

VENDIM
Nr. 658, datë 2.9.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR DHËNIEN E MEDALJES SË
SHËRBIMIT TË RENDIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 17, të ligjit nr. 93/2022, “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e kriterëve për dhënie e Medaljes së Shërbimit të Rendit Publik shtetasve shqiptarë dhe të huaj, që kanë dhënë kontribut të veçantë në luftën kundër krimit, mbrojtjen e jetës, rendit dhe qetësisë publike, ruajtjen dhe administrimin e pronës, kontrollin e situatave të jashtëzakonshme, si dhe në ushtrimin me kurajë e guxim të detyrave dhe përgjegjësi në fushën e rendit e të sigurisë publike.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Ky vendim zbatohet për punonjësit e strukturave shtetërore, që ushtrojnë funksione në fushën e rendit e të sigurisë publike, përfshirë Policinë e Shtetit dhe shërbimet e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin. Ai zbatohet, gjithashtu, edhe për shtetasit shqiptarë dhe të huaj, që kanë dhënë kontribut të veçantë në ruajtjen e rendit e të sigurisë publike.

KREU II
KRITERET PËR DHËNIEN E MEDALJES SË SHËRBIMIT TË RENDIT PUBLIK

Neni 3
Kriteret e përgjithshme

1. Medalja e Shërbimit të Rendit Publik u jepet shtetasve shqiptarë dhe të huaj, që kanë dhënë kontribut të dalluar:

- a) në luftën kundër krimit dhe parandalimin e veprimtarive kriminale;
- b) në mbrojtjen e jetës, shëndetit, integritetit dhe sigurinë e qytetarëve;
- c) në ruajtjen, administrimin dhe mbrojtjen e pronës publike e private;
- ç) në garantimin e rendit, qetësisë publike e menaxhimit të situatave të konfliktit, duke respektuar liritë dhe të drejtat themelore të njeriut;
- d) në menaxhimin dhe kontrollin e situatave të jashtëzakonshme;
- dh) në ushtrimin me kurajë e guxim dhe përkushtim të detyrave në fushën e rendit e të sigurisë publike;
- e) veçanërisht në rrethana që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme.

2. Përfituesi i medaljes, duhet:

- a) të mos jetë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale;
- b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

c) të ketë demonstruar sjellje të lartë qytetare, integritet moral dhe etikë profesionale, si dhe përkushtim të vazhdueshëm në ushtrimin e detyrave funksionale;

ç) të ketë dhënë kontribut në ruajtjen dhe forcimin e autoritetit, besueshmërisë e të imazhit institucional të strukturës përkatëse.

3. Për verifikimin e përmbushjes së kriterëve, propozimi shoqërohet me dokumentacion provues, përfshirë vërtetime, raporte zyrtare, vlerësime profesionale ose dokumente të tjera, të lëshuara nga autoritetet kompetente shqiptare ose të huaja. Për shtetasit, kriteret e parashikuara në pikën 2, të këtij kreu, zbatohen për aq sa janë të aplikueshme.

Neni 4

Kriteret e veçanta për dhënien e medaljes për punonjësit në Policinë e Shtetit

1. Medalja e Artë e Shërbimit të Rendit Publik u jepet punonjësve të Policisë së Shtetit që kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në përmbushjen e detyrave funksionale, në një nga rastet e mëposhtme:

a) Kryejnë akte heroike të dokumentuara, duke rrezikuar jetën e tyre për mbrojtjen e qytetarëve;

b) Parandalojnë ose neutralizojnë kërcënime, që lidhen me ngjarje shumë të rënda (terroriste, kriminale, emergjenca civile me rrezik masiv), të vërtetuara nga raportet zyrtare të Policisë së Shtetit;

c) Drejtojnë dhe realizojnë me sukses operacione të mëdha me ndikim kombëtar e ndërkombëtar;

ç) Shërbejnë në strukturat e Policisë së Shtetit, për jo më pak se 30 (tridhjetë) vjet, e gjatë kësaj periudhe kanë dëshmuar profesionalizëm dhe sjellje shumë të mirë, sipas vlerësimeve të tyre në punë;

d) Kryejnë apo ndërmarrin akte të sakrificës personale, që kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e sigurisë publike, duke parandaluar humbjen e jetës, dëmtimet e rënda fizike të qytetarëve ose përshkallëzimin e një situatë të rrezikshme.

2. Medalja e Argjendtë e Shërbimit të Rendit Publik u jepet punonjësve të Policisë së Shtetit që kanë dhënë kontribut të dalluar profesional dhe operacional në ushtrimin e detyrave funksionale, në një nga rastet e mëposhtme:

a) Kryejnë veprime të guximshme, të dokumentuara, në luftën kundër krimit, sidomos ndaj krimit të organizuar dhe autorëve të rrezikshëm;

b) Japin ndihmesë të dukshme në operacione policore ose të mbrojtjes civile, me ndikim të madh në sigurinë publike;

c) Menaxhojnë me efektivitet situata emergjente, operacione shpëtimi ose ngjarje që kanë paraqitur rrezik për jetën, pronën ose rendin publik;

ç) Shërbejnë në strukturat e Policisë së Shtetit, për jo më pak se 20 (njëzet) vjet, e gjatë kësaj periudhe kanë dëshmuar profesionalizëm dhe sjellje shumë të mirë, bazuar në vlerësimin e tyre në punë;

d) Realizojnë veprimtari të veçanta shkencore, profesionale ose drejtuese, që kanë kontribuar në forcimin e rendit e të sigurisë publike.

3. Medalja e Bronztë e Shërbimit të Rendit Publik u jepet punonjësve të Policisë së Shtetit, që kanë dhënë kontribut të dalluar në ushtrimin e detyrës, në një nga rastet e mëposhtme:

a) Kryejnë me profesionalizëm, kurajë ose efektivitet të dalluar veprime konkrete në mbrojtje të qytetarëve dhe ruajtjes së rendit publik;

b) Shërbejnë në strukturat e Policisë së Shtetit, për jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, e gjatë kësaj periudhe kanë dëshmuar profesionalizëm dhe integritet në kryerjen e detyrave të përditshme me ndikim të ndjeshëm në komunitet, bazuar në vlerësimin e tyre në punë;

c) Japin kontribut të dalluar në operacione të përbashkëta, patrullime apo kontrolle, që kanë sjellë rezultate të dukshme për komunitetin në forcimin e sigurisë publike dhe rritjen e besueshmërisë së publikut ndaj institucionit.

Neni 5

Kriteret e veçanta për dhënien e Medaljes së Shërbimit të Rendit Publik për punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin

1. Medalja e Artë e Shërbimit të Rendit Publik u jepet punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin që kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në ushtrimin e detyrës, në një nga rastet e mëposhtme:

a) Kryejnë akte heroizmi ose sakrifice personale gjatë operacioneve të shpëtimit ose mbrojtjes nga zjarri, duke rrezikuar jetën për shpëtimin e qytetarëve;

b) Udhëheqin dhe menaxhojnë me sukses operacione madhore të sigurisë nga rreziku i zjarrit dhe/ose shpëtimit, me ndikim të drejtpërdrejtë e të matshëm në shpëtimin e jetëve dhe pronës;

c) Demonstrojnë gjatë ushtrimit të detyrës profesionalizëm, përkushtim dhe kontribut të shtuar në operacione të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, të vlerësuara pozitivisht përgjatë karrierës së tyre profesionale dhe ky kontribut është dëshmuar në mënyrë të vazhdueshme, prej jo më pak se 25 (njëzet e pesë) vjetësh në shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.

2. Medalja e Argjendtë e Shërbimit të Rendit Publik u jepet punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, që kanë dhënë kontribut të dalluar profesional dhe operacional në ushtrimin e detyrës, në një nga rastet e mëposhtme:

a) Kryejnë veprime të dokumentuara guximtare, të vërtetuara me raporte zyrtare të ngjarjes në situata rreziku, që kanë rezultuar me shpëtimin e jetës e të pronës dhe parandalimin e pasojave të rënda;

b) Marrin pjesë në mënyrë aktive të suksesshme në veprime operacionale operuese dhe/ose menaxhuese të rëndësishme, në nivel kombëtar, rajonal ose ndërkombëtar;

c) Demonstrojnë gjatë ushtrimit të detyrës profesionalizëm, përkushtim dhe kontribut të shtuar në operacione të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, të vlerësuara pozitivisht përgjatë karrierës së tyre profesionale, dhe ky kontribut është dëshmuar në mënyrë të vazhdueshme, prej jo më pak se 20 (njëzet) vjetësh në shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.

3. Medalja e Bronztë e Shërbimit të Rendit Publik u jepet punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin që kanë dhënë kontribut të dalluar në ushtrimin e detyrës, në një nga rastet e mëposhtme:

a) Kryejnë me përkushtim dhe profesionalizëm detyrat në situata të vështira, duke dhënë kontribut efektiv në stabilizimin e situatës, parandalimin e përhapjes së zjarrit ose minimizimin e pasojave;

b) Marrin pjesë në mënyrë aktive dhe efektive në operacione të rëndësishme për fikjen e zjarreve dhe shpëtimin, duke realizuar izolimin e vatrave të zjarrit, evakuimin e personave, shpëtimin e jetëve ose mbrojtjen e pronës;

c) Japin kontribut të shtuar në trajnimin dhe rritjen e kapaciteteve profesionale të strukturave të shërbimit zjarrfikës, duke hartuar, duke zhvilluar ose duke zbatuar programe trajnimi me ndikim të veçantë në përmirësimin e kapaciteteve operacionale;

ç) Tregojnë sjellje shumë të mirë në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi (sipas vlerësimeve në punë), me karrierë jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) vjet në shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.

Neni 6

Kriteret e veçanta për dhënien e medaljes së shërbimit të rendit publik për shtetasit shqiptarë ose të huaj

1. Medalja e Shërbimit të Rendit Publik, në nivelin “E artë”, “E argjendtë” ose “E bronzhtë”, i jepet shtetasit shqiptar ose të huaj që ka dhënë kontribut të dalluar, të dokumentuar dhe të verifikueshëm në mbrojtjen e jetës dhe pronës, forcimin e rendit e të sigurisë publike, menaxhimin e situatave të jashtëzakonshme ose forcimin e bashkëpunimit në fushën e rendit e të sigurisë publike.

2. Medalja e Artë e Shërbimit të Rendit Publik i jepet shtetasit shqiptar ose të huaj për **akte heroizmi dhe ndërhyrje të jashtëzakonshme, si:**

- a) shpëtimi i jetëve të qytetarëve dhe forcimi i rendit publik;
- b) ndërhyrje të dokumentuara në operacione kundër krimit të organizuar, terrorizmit ose situatave që rrezikojnë sigurinë kombëtare;
- c) veprime të jashtëzakonshme gjatë fatkeqësive natyrore, zjarreve ose situatave emergjente.

3. Medalja e Argjendtë e Shërbimit të Rendit Publik i jepet shtetasit shqiptar ose të huaj për kontribut të dalluar në ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, si:

- a) pjesëmarrje aktive dhe efektive në operacione të rëndësishme policore, të mbrojtjes civile ose emergjencave, me rezultat të verifikueshëm në uljen e rrezikut për jetën dhe pronën;
- b) dhënie e kontributit të specializuar (profesional, teknik, analitik ose organizativ), që ka ndikuar në rritjen e efikasitetit të strukturave të rendit e të sigurisë publike.

4. Medalja e Bronztë e Shërbimit të Rendit Publik i jepet shtetasit shqiptar ose të huaj për kontribut mbështetës dhe bashkëpunues, në funksion të rendit e të sigurisë publike, si:

- a) mbështetja në realizimin e operacioneve ose aktiviteteve të strukturave të rendit dhe të sigurisë publike, me ndikim të drejtpërdrejtë në zbatimin e detyrave institucionale;
- b) kontribut në iniciativa, projekte ose aktivitete, që synojnë parandalimin e rreziqeve ndaj rendit publik dhe rritjen e sigurisë në komunitet;
- c) bashkëpunimi i dokumentuar me institucionet përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, në forma logjistike, teknike ose organizative.

KREU III DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 7

Organet e ngarkuara për zbatim dhe hyrja në fuqi

Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama